



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 1052/1 prot.

Tiranë më 24.04.2026

Lënda: Mendim mbi projektligjin “*Për censin e bujqësisë*”

MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “*Zyra e Komisionerit*”) ka administruar shkresën tuaj me nr. 2667/4 prot., datë 15.04.2026, protokolluar me tonën me nr. 1052 prot., datë 15.04.2026, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektligjin “*Për censin e bujqësisë*”, së bashku me relacionin shoqërues.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së projektligjit, në kuadër të garantimit të përputhshmërisë me ligjin nr.124/2024 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*” (në vijim “*Ligji nr.124/2024*”) vlerësojmë të mbahen në konsideratë komentet dhe sugjerimet e mëposhtme.

Fillimisht, ***në pikën 14 të nenit 4 të projektligjit***, sugjerojmë që përkufizimi “*të dhëna personale*” të zëvendësohet me “*“Të dhëna personale” kanë të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale*”.

Sa i përket pikës 3 të nenit 6 të projektligjit, vërejmë se në të parashikohet se institucionet publike vënë në dispozicion të INSTAT të dhëna administrative (*duke përfshirë dhe të dhëna personale, të cilësuar në pikën 2 të këtij neni*). Neni 33 i ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare” i njeh INSTAT-it të drejtën e aksesit në këto të dhëna për qëllime statistikore, por kjo dispozitë mbetet e përgjithshme dhe nuk përcakton në mënyrë të plotë kushtet dhe garancitë që lidhen me përpunimin e të dhënave personale.

Për rrjedhojë, me qëllim garantimin e parimeve të ligjshmërisë, transparencës, minimizimit dhe sigurisë së të dhënave, vlerësohet e nevojshme që të përcaktohen qartë rregullat e bashkëpunimit ndërmjet palëve, përfshirë rolet dhe përgjegjësitë, kategoritë e të dhënave, qëllimin e përpunimit, mënyrën e transmetimit, masat e sigurisë dhe afatet e ruajtjes (*parashikuar në nenin 6, të Ligjit nr. 124/2024*).

Për sa më sipër, sugjerojmë që **pas pikës 3, të nenit 6 të projektligjit** të shtohet një pikë 4, me këtë përmbajtje: “4. Për zbatimin e këtij neni, marrëdhëniet ndërmjet INSTAT-it dhe institucioneve publike për vënien në dispozicion të të dhënave personale rregullohen nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit në të cilat përcaktohen, ndër të tjera, baza ligjore, qëllimi, kategoritë e të dhënave që shkëmbehen, rolet dhe përgjegjësitë e palëve, mënyrat dhe kushtet e transmetimit, masat e sigurisë, si dhe afatet e ruajtjes së të dhënave, në përputhje me legjislacionin për statistikën zyrtare dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Në pikën 6, të nenit 14 të projektligjit parashikohet termi “kodohen” në lidhje me përpunimin e të dhënave personale. Me qëllim harmonizimin e terminologjisë së përdorur në projektligj me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale (konkretisht me pikën 20 dhe 29 të nenit 5, dhe parashikimeve të nenit 45 të Ligjit nr.124/2024), sugjerojmë që në vend të termit “kodohen” të përdoren termat “pseudonimizohen/anonimizohen”.

Gjithashtu referuar sa më sipër, sugjerojmë që këto dy terma mund të shtohen **edhe në nenin 4 të projektligjit** sipas përkufizimit: “Pseudonimizim/anonimizim” kanë të njëjtin kuptim me përkufizimet e dhëna në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Në vijim, lidhur me pikën 7 të nenit 14 të projektligjit është përcaktuar se të dhënat e mbledhura të censit ruhen sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për statistikën zyrtare. Ndërkohë, projektligji nuk parashikon në mënyrë të shprehur mënyrën e trajtimit të të dhënave personale pas përmbytjes së qëllimit të përpunimit, në përputhje me parimin e kufizimit të ruajtjes. Në këtë kuadër, sugjerohet që **në pikën 7 të nenit 14 të projektligjit** të shtohet edhe një fjali me këtë përmbajtje: “Pas përfundimit të afatit të ruajtjes, të dhënat personale fshihen ose anonimizohen në përputhje me procedurat e miratuara”.

Në lidhje me **nenin 28 të projektligjit**, konstatojmë se ky nen paraqitet i paqartë si në aspektin e përmbajtjes por njëkohësisht edhe në ndarjen e kompetencave dhe procedurave administrative të ankimit, duke krijuar keqinterpretim në raport me Ligjin nr. 124/2024.

Në këtë drejtim sqarojmë se, rastet e pretendimeve për shkelje ligjore në përpunimin e të dhënave personale, shqyrtohen dhe trajtohen nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si autoriteti i vetëm mbikëqyrës dhe i pavarur që monitoron zbatimin e dispozitave të Ligjit nr. 124/2024.

Parashikimet e nenit 29 të projektligjit krijojnë konfuzion si dhe përcaktojnë një procedure të dyfishtë ankimi jo të mirëpërcaktuar, mospërputhje të afateve procedurale, si dhe mbivendosje të kompetencave, për këto arsye vlerësojmë rishikimin në tërësi të dispozitës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Gjithashtu sugjerojmë që në të gjithë përmbajtjen e projektligjit të rishikohet numërtesa e neneve, në raport me referencat në përmbajtje të dispozitave.

Në përfundim, në relacionin shoqërues në lidhje me nenin 14 sugjerojmë që togfjalëshi “...të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar” të zëvendësohet me togfjalëshin “...të ligjit nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale””.

Siç dhe mund të jeni në dijeni, nga shkurti i vitit 2025 ka hyrë në fuqi ligji nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i përafruar plotësisht me Rregulloren e Përgjithshme të BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR), i cili ka shfuqizuar ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Për sa më sipër, çdo përpunim i të dhënave personale, apo dokumentacion i hartuar duhet të kryhet në përputhje me dispozitat e ligjit të ri dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi